



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

**VENDIM
Nr. 34, Datë 27.03.2024**

**MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 597/7 prot., datë 25.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 597 prot., datë 07.02.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe bordi i ERE-s, me vendimin nr. 23, datë 19.02.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Protergia Energy albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.02.2024 dhe 22.02.2024), dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 01.03.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 597/3 prot., datë 23.02.2024, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 23/2024 dhe i evidentoi informacionin/dokumentacionin që mbetej pa plotësuar nga ky aplikim. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 597/4 prot., datë 28.02.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të sa depozituar, rezultoi se kishte ende dokumentacion të paplotësuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 597/5 prot., datë 13.03.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 597/6 prot., datë 21.03.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik” e ndryshuar.
- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NE DETYRE

Erjola SADUSHI